



**VENDIM**

**Nr. 90 Datë 15.07.2015**

**PËR**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES  
MBI PROCEDURAT PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË  
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT**

Bazuar ne nenin 9, të Ligjit nr. 9946, date 30.06.2008 “Për Sektorin e Gazit Natyror” nenet 7 dhe 149 te Ligjit Nr. 8485, date 12.05.1999, Kodi i Procedurave Administrative te Republikës se Shqipërisë, i ndryshuar, Traktatit te Komunitetit te Energjisë te ratifikuar me Ligjin nr. 9501, date 03.04.2006, Rregullat per organizimin, Funksonimin dhe procedurave te ERE-s, Vendimit te Keshillit Ministerial Nr. D/2011/02/MC-EnC, si dhe ne përputhje me Direktiven 2009/73-EC dhe Rregulloren EC Nr.715/2009, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 15.07.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punes të Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të Gazit, dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të Gazit,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të Gazit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**

**Petrit AHMETI**